

Të nderuar,

Mirë se erdhët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kemi nderin dhe kënaqësinë e veçantë që vendosët ta vizitoni shtëpinë ligjvënese, e cila është një karakteristikë e rëndësishme e shtetësisë maqedonase.

Nëpërmjet vizitës së organizuar në pjesën solemne të objektit, do të keni mundësi të njiheni me

historinë e ndërtesës, brendësinë dhe hapësirat më reprezentative të institucionit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Përmbajtja

Çfarë përfaqëson Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut?.....	2
Ndërtesa e Kuvendit gjatë historisë	7
Brendësia e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut...11	
Kryetarët e Kuvendit	23
Dita e hapur në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut	26

Çfarë përfaqëson Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut?

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut është trup përfaqësues njëdhomësh i qytetarëve, mbartës i pushtetit ligjvënës në Republikë. Kompetenca themelore e Kuvendit është miratimi i ligjeve me të cilat rregullohen juridikisht marrëdhëniet shoqërore dhe përcaktohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë për subjektet shoqërore.

Kuvendin e përbëjnë 120 deri në 140 deputetë, të cilët zgjidhen në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë. Deputeti i përfaqëson qytetarët dhe në Kuvend vendos sipas bindjes së tij. Mandati i deputetëve zgjat katër orë dhe ata nuk mund të revokohen.

Organizimi dhe funksionimi i Kuvendit përcaktohen me Kushtetutë, Ligjin për Kuvendin dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut:

- E miraton dhe ndryshon Kushtetutën;
- Miraton ligje dhe jep interpretim autentik të ligjeve;
- I përcakton detyrimet publike;
- E miraton buxhetin e Republikës dhe llogarinë përfundimtare;
- E miraton planin hapësinor të shtetit;
- I ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare;
- Vendos për luftë dhe për paqe;
- Merr vendime për ndryshim të kufijve të vendit;
- Merr vendime për futje dhe dalje nga aleanca apo bashkësia me disa shtete;
- Shpall referendum;
- Vendos për rezervat e shtetit;

- Themelon këshilla;
- E zgjedh Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- I zgjedh gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Kryen përzgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e mbartësve të tjerë të funksioneve publike e të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj;
- Kryen kontroll politik dhe mbikëqyrje të Qeverisë dhe të mbartësve të tjera të funksioneve publike që janë përgjegjës para Kuvendit;
- Jep amnisti dhe
- Kryen punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Kuvendi për kryerjen e punëve në kompetencë të tij miraton vendime, deklarata, rezoluta, rekomandime dhe përfundime.

PUNA E KUVENDIT

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut është në punime të përhershme dhe punon me seanca. Kuvendi mund të punojë nëse në seancë merr pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Kuvendi vendos me shumicë votash të deputetëve të pranishëm, kurse minimum me një të tretën e numrit të përgjithshëm të deputetëve, nëse nuk është paraparë shumicë e veçantë në Kushtetutë.

Seancat e Kuvendit i thërret dhe ato i udhëheq Kryetari i Kuvendit. Seancat janë publike, por Kuvendi mund të vendosë të punojë pa praninë e publikut, kjo miratohet me dy të tretat e shumicës së numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Seancat sipas rregullit mbahen nga ora 11:00 deri në orën 18:00 me një pauzë prej një ore, nëse Kryetari i Kuvendit për seanca të ndryshme nuk vendos ndryshe.



Kryetari i Kuvendit mund të caktojë seancë edhe me kërkesë të Kryetarit të Republikës, të Qeverisë dhe të 20 deputetëve minimum.

TRUPAT PUNUES (KOMISIONE)

Që të shqyrtohen në mënyrë të detajuar propozim ligjet dhe çështjet e tjera që janë në kompetencë të Kuvendit, në suazat e tij formohen trupat e përhershëm punues dhe trupat e përkohshëm punues që kontribuojnë për një punë të tij më efikase.

Trupat e përhershëm punues (komisionet) themelohen në fillim të mandatit të Kuvendit dhe funksionojnë gjatë të gjithë mandatit, ndërsa trupat e përkohshëm formohen sipas nevojës. Trupat punues themelohen me vendim të Kuvendit.

Trupat punues konstituohen sipas fushave, kështu që propozimet e ligjeve dhe aktet e tjera i shqyrton trupi punues amë dhe Komisioni Juridiko-Ligjvënës. Për çdo çështje që shqyrton, trupi punues mban qëndrim dhe dorëzon raport në Kuvend.

Përbërja e trupave punues përcaktohet në varësi të numrit të deputetëve në grupet parlamentare, deputetëve të cilët nuk janë organizuar në grup parlamentar dhe në përputhje me Ligjin për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave.

FUNKSIONI KONTROLLUES DHE MBIKËQYRËS I KUVENDIT

Kontrolli politik dhe mbikëqyrja e Qeverisë dhe të mbartësve të tjerë të funksioneve publike që janë përgjegjës para Kuvendit është një prej kompetencave të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktuara me Kushtetutë. Mekanizmat më të rëndësishëm për realizimin e funksionit kontrollues dhe mbikëqyrës të Kuvendit janë: Pyetjet e deputetëve, interpelanca, komisionet anketuese, votimi i mosbesimit për Qeverinë dhe debatet mbikëqyrëse.

Çdo deputet ka të drejtë t'u parashtrojë pyetje, në lidhje me punën e tyre ose punën në kompetencë të tyre, Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, një anëtar të Qeverisë dhe mbartësve të tjerë të funksioneve publike të cilët janë përgjegjës para Kuvendit . Për parashtrimin e pyetjeve të deputetëve caktohet seancë e veçantë plenare e Kuvendit, çdo të enjten e fundit të muajit.

Interpelancë mund të kërkojnë minimum pesë deputetë në lidhje me punën e mbartësit konkret të funksionit publik, Qeverisë dhe çdo anëtar të saj, si dhe në lidhje me çështje mbi punën e organeve shtetërore.

Kuvendi mund të themelojë komisione anketuese për të gjitha fushat dhe për çdo pyetje me interes publik. Propozim për themelim të komisionit anketues mund të dorëzojnë minimum 20 deputetë.

Pyetje për besim të Qeverisë mund të parashtrojnë minimum 20 deputetë, në formë të shkruar dhe me arsyetim të shkaqeve. Kuvendi mund të votojë mosbesim me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Debatet mbikëqyrëse mbahen që të merren informacione dhe mendime



eksperte në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikave, zbatimit të ligjeve dhe aktiviteteve të tjera të Qeverisë dhe të organeve të administratës shtetërore. Debatin mbikëqyrës e zbaton trupi punues amë në

fushëveprimin e të cilit hyn edhe çështja që është lëndë e këtij debati mbikëqyrës.

Publiku në punë

Seancat e Kuvendit mund të ndiqen drejtpërdrejt në Kanalin e Kuvendit të Radiotelevizionit Maqedonas, si dhe në internet, nëpërmjet faqes së internetit të Kuvendit <www.sobranie.mk>.

Përfaqësuesit e mjeteve për informim publik kanë të drejtë të marrin pjesë në seancat e Kuvendit dhe në seancat e trupave punues, që të informojnë publikun mbi punën e tyre.

Qytetarët mund t'i ndjekin seancat e Kuvendit dhe të trupave punues nga galeria, në përputhje me dispozitat e rendit të brendshëm të Kuvendit.

Ndërtesa e Kuvendit gjatë historisë

Ndërtesa e Kuvendit është një nga ndërtesat më monumentale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është ndërtuar në vitin 1938, me projektin e arkitektit çek Viktor J. Hudak. Objekti është konceptuar të jetë me stil modern arkitektonik për atë kohë, në formë të pesëkëndëshit të jashtëm me oborr të brendshëm me sallë.

Ndërtesa është në përdorim që në vitin 1939 si Pallat drejtues i administratës së atëhershme lokale. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, në këtë ndërtesë kanë qenë shtabet e ushtrive okupuese dhe të forcave policore.



Pas çlirimit të Shkupit në vitin 1994, në këtë ndërtesë është vendosur administrata e tërësishme e pushtetit të ri popullor:

- Presidenti i Presidiumit të Kuvendit Popullor;
- Kuvendi Popullor;
- Këshilli Ekzekutiv dhe
- Gjykata Kushtetuese.

Në vitin 1954, sipas projektit të Millan Miniq, janë ndërtuar: Salla Solemne dhe Salla 2, kurse me enterier janë rregulluar sallat më të vogla në pjesën solemne, Dhoma e Ohrit dhe Dhoma e Strugës, me gdhendje në dru të tavaneve, mureve dhe dyerve të gdhendura nga mjeshtrit e shkollës tradicionale për gdhendje në dru nga Ohri, si dhe me dekorim gipsi i punuar nga mjeshtrit nga Rajoni i Drimkollit. Salloni i vogël solemn, Salla e Komisionit Kushtetues, restoranti, si edhe kabinetet janë veshur me dërrasa me intarsia.

Gjatë tërmetit të vitit 1963, ndërtesa e Kuvendit ishte dëmtuar dukshëm, kështu që u bënë ndërhyrje të mëdha për restaurimin dhe rikonstruksionin e saj.



Në vitin 1966/67 u bë rikonstruksioni dhe u restaurua përbrenda Salla Parlamentare, kurse janë ndërtuar edhe dy salla të reja Salla 3 dhe Salla 4.

Pas pavarësimit të shtetit në vitin 1991, në këtë ndërtesë krahas Kuvendit, në një pjesë të katit të parë është vendosur edhe Kabineti i Presidentit të Republikës. Në maj të vitit 2009, Kabineti i Presidentit të Republikës ka kaluar në vilën presidenciale në Vodno.

Pallati i Kuvendit ka në dispozicion shumë salla për seanca, Kabinete të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, të nënkryetarëve, të kryetarëve të komisioneve, të koordinatorëve të grupeve të deputetëve, të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, të zëvendësve të tij, si dhe të udhëheqësve të shërbimeve profesionale dhe të sektorëve.

Në vitin 1994 u bë restaurimi i brendshëm i Kabinetit të Kuvendit si dhe i korridorit para kabinetit.

Në vitin 1998 dhe 1999 është kryer restaurimi i brendshëm i Sallës Parlamentare (Salla 1), kështu salla e ka marrë pamjen e tanishme.

Në vitin 2003 janë kryer ndërhyrje më të mëdha. Është kryer rikonstruktim i instalimit elektrik, është vendosur instalim i tërësishëm zjarrfikës, ka ndryshuar i gjithë rrjeti telefonik, zgjidhja për dritën në të gjithë ndërtesën, janë shtruar korridoret me pllaka graniti, janë bërë tavane të ulura, janë vendosur dyer të reja kontrolluese, kurse është bërë edhe rikonstruktim i nyjave sanitare dhe i zyrës së regjistrimit.

Në vitin 2004, në Kuvend u hap Dhoma përkujtimore me rastin e 60-vjetorit të Mbledhjes I të KAÇKM-së.

Në vitin 2005 u realizua projekti për hyrje-dalje dhe lëvizje pa pengesa të personave me nevoja të veçanta në objektin e Kuvendit, me vendosje të platformës për hyrje-dalje në hyrjen e Zyrës së regjistrimit, ashensor i vendosur në oborrin e brendshëm dhe katër elevatorë-platforma lëvizëse në shkallët e brendshme si dhe hyrje e veçantë me tra për në restorantin që gjendet në suterren.

Në periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2016 është realizuar projekti për ndërtim, mbindërtim, adaptim dhe përfortim të objektit të Kuvendit.

Mbindërtimi është objekt i ri në pesë nivele në pjesën e mesme të ndërtesës. Në katin përdhes dhe tri katet e tjera janë vendosur 24 hapësira pune, ashensor, dy



hapësira për shkallët dhe dy ura për lidhje me të gjitha katet e objektit ekzistues. Në nivelin më të lartë, katin e katër është vendosur një sallë për mbajtjen e evenimenteve të ndryshme nën kupolën e madhe.

Në përputhje me nevojat, bëhen vazhdimisht intervenime në funksion të përmirësimit të kushteve të punës për deputetët dhe Shërbimin e Kuvendit dhe për krijimin e një hapësire bashkëkohore dhe moderne për të mbajtur aktivitete të larta dhe të rëndësishme protokollare, ndërkohë që i kushtohet vëmendje ruajtjes së autenticitetit të ndërtesës si përmendore e kulturës.



Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut mbrohet me Ligjin për mbrojtjen e përmendoreve të kulturës dhe është një nga karakteristikat më të rëndësishme të qytetit të Shkupit dhe të shtetit.

Brendësia e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

HYRJA KRYESORE E KUVENDIT



Hyrja kryesore e Kuvendit ka karakter protokollar dhe e përdor Kryetari i Kuvendit, nënkryetarët, deputetët, kryeministri dhe ministrat, Kryetari i shtetit, funksionarët e lartë shtetërorë dhe përfaqësuesit e trupit diplomatik.

Muret nga ana e majtë dhe ana e djathtë e hyrjes kryesore janë zbukuruar me kopje të tri afreskeve:



“Kungimi i apostujve”, i punuar në vitin 1982 nga Nikolla Conev, në pëlhurë me temperë, kurse është kopje e afreskut nga kisha e “Shën. Kollit”, viti 1271, në fshatin Manastir, Rajoni i Mariovës.

“Tradhtia e Judës” dhe “Ngritja në kryq”, të punuara në vitin 1974 nga Ganço Boshkovski, në pëlhurë me temperë, kurse janë kopje të

afreskeve të Kishës “**Shën. Mëria Perivlepta (Shën. Klimenti)**”, viti 1295, në Ohër.

Shkallët kryesore në Kuvend çojnë te Kabineti i Kryetarit të Kuvendit. Shkallët janë të punuar me mermer maqedonas, me ngjyrë të bardhë për shkallët dhe me ngjyrë hiri për parmakët. Në këtë vend, pas zgjedhjes së Qeverisë së re, bëhet fotografia e parë e përbashkët e anëtarëve të saj.



Nga të dyja anët e shkallëve kryesore janë vendosur skulpturat “**Gruaja me varg duhani**” dhe “**Vajtimi**”, të punuara nga artisti i shquar maqedonas, Dimo Todorovski, në vitin 1960 dhe 1970.

Në suazat e hyrjes kryesore është vendosur edhe një pllakë në të cilën është shënuar data 16 prill 1945, kur në Kuvend është miratuar Ligji i Kuvendit dhe me dekret të Presidiumit të Kuvendit është formuar qeveria e parë popullore e Maqedonisë. Kështu, KAÇKM-ja është riemëruar si Kuvendi Popullor i Maqedonisë.

SALLA MAQEDONIA



Salla shfrytëzohet që nga viti 1945 për mbajtjen e seancave plenare të Kuvendit. Salla është e ndërtuar në vitin 1938. Rikonstrukcioni i parë i sallës është bërë në vitin 1967, kurse enterieri aktual është realizuar në vitin 1998 dhe 1999.

Me rikonstrukcionin në vitin 1999, janë vendosur sistemi elektronik i votimit dhe fjalimit dhe sistemi video, me kamera fikse për transmetim të drejtpërdrejtë televiziv. Në nëntor të vitit 2015, salla është riemëruar nga "Salla 1" në salla "Maqedonia". Ulëset në sallë janë të ndara në tri pjesë. Ulëset me ngjyrë të kaltër janë për deputetët, ndërsa ulëset në pjesën e djathtë me ngjyrë vjollcë janë për përfaqësuesit e Qeverisë. Deputetët e partive politike që janë pjesë e shumicës qeveritare ulen në pjesën e mesme dhe në pjesën pas përfaqësuesve të Qeverisë, ndërsa deputetët e partive politike që janë në opozitë ulen në pjesën e majtë.

Salla ka edhe galeri, të cilën gjatë seancave të rregullta të Kuvendit e shfrytëzojnë gazetarët dhe vizitorët e tjerë, ndërsa në seanca solemne-përfaqësuesit e korit diplomatik në shtet (ambasadorë të shteteve të huaja të akredituar në Republikën e Maqedonisë së Veriut). Pjesa e ndarë e galerisë është për Kryetarin e Republikës dhe përfaqësuesit e kabinetit të tij. Nën galeri ka dy kabina teknike të pajisura për transmetim televiziv dhe të radios dhe dy kabina për përkthim simultan.



Gjatë rikonstruksionit të sallës në vitin 1999, muret e sallës janë të dekoruara me katër mozaikë të punuar me teknikën bizantine të artistit të shquar Gazanfer Bajram. Murin nga ana e majtë e zbukurojnë mozaikët "**Himni**" dhe "**Orfeu i Maqedonisë**", ndërsa nga ana e djathtë mozaikët "**Rrathët e qytetërimit**" dhe "**Kortezhi i dasmës**".



SALLA E QEVERISË

Enterieri i sallës është i rregulluar në vitin 1999, ndërsa e shfrytëzon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për nevojat e saj gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit. Gjatë ditëve të tjera sala ka më tepër dedikime dhe



shfrytëzohet për punë protokollare, nënshkrim të deklaratave, mbledhje të trupave punues të Kuvendit, takime pune dhe aktivitete të tjera.

KABINETI I KRYETARIT TË KUVENDIT

Enterieri i kabineti është i rregulluar me rikonstruksionin e parë të objektit të Kuvendit në vitin 1954, sipas projektit të arkitektit Millan Miniq, me dërrasa në intarsia dhe tavane me dekorime prej gipsi të punuara nga mjeshtërit e Drimkolit. Mobiljet me gdhendje nga druri janë bërë në vitin



1993. Kryetari i Kuvendit e shfrytëzon Kabinetin si hapësirë pune nga muaji maj 2009, ndërsa më parë Kabinetin e shfrytëzonin kryetarët e deritanishëm të Republikës.

SALLA ME DRUGDHENDJE TË THELLË




Salla është pjesë e Kabinetit të Kryetarit të Kuvendit dhe përdoret për nevoja protokollare të Kryetarit. Dekorimi i sallës është projektuar në periudhën nga viti 1935 deri në vitin 1937 nga Dragutin Inkiostri Medenjok, ndërsa është

realizuar në vitin 1938 nga Glisha Kostovski, marangoz dhe drugdhendës nga Tetova. Muret dhe tavani janë të veshura me dru me gdhendje sipërfaqësore dhe të thellë të drurit të arës, me përmbajtje ornamentale dhe motive gjeometrike, vegjetative, zoomorfe dhe të tjera. Në mes të hapësirës është e vendosur stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe flamuri i shtetit. Për nder të kryetarit të parë të Presidiumit të Kuvendit, Metodija Andonov Çento, në hapësirë është e vendosur skulptura e tij.

KORRIDORI I PORTRETEVE

Korridori gjendet para Kabinetit të Kryetarit të Kuvendit, ndërsa është ndërtuar dhe rregulluar në vitin 1954. Në vitin 2000, në korridor janë vendosur portretet e të gjithë kryetarëve të Kuvendit që nga viti 1945 deri më sot. Portretet janë të punuar nga artistë të shquar maqedonas me teknikë vaj në beze.



Korridori shfrytëzohet për dhënie të deklaratave nga Kryetari i Kuvendit dhe mysafirët e tij. Në hapësirë është i vendosur Libri i përshtypjeve ku të gjithë mysafirët i shkruajnë përshtypjet e tyre nga vizita e Kuvendit.

SALLA E KRISTALTË

Salla është e ndërtuar në vitin 1954, si ndërtim plotësues në oborrin e Kuvendit, ndërsa pamjen aktuale e ka nga viti 2001, kur është kryer rregullimi i enterierit. Shfrytëzohet për aktivitete protokollare, siç janë konferencat, pritjet solemne, koktejet dhe ndarja e çmimeve. Është emëruar sipas pesë abazhurëve të punuar me kristale origjinale. Në murin e majtë ka një pasqyrë të madhe



në formë origjinale, ndërsa në murin e djathtë është i vendosur punimi në dru me temë "Serdarot", i punuar nga autori Boro Mitriqeski.

Në Sallën e Kristaltë ndahen çmimet e larta shtetërore: "11 tetori" (më 11 tetor), "Shën. Klimenti i Ohrit" (më 8 dhjetor), "Goce Dellçev" (më 4 maj), "Mito Haxhivasilev Jasmin" (më 21 dhjetor) dhe "Nënë Tereza" (më 26 gusht).

KORRIDORI PARA SALLËS SË KRISTALTË



Korridorin është i ndërtuar dhe rregulluar në vitin 1954, ndërsa pamjen aktuale e ka nga viti 2001. Në vitin 2002 në korridor janë të vendosura vitrina ku janë të ekspozuara dhuratat që i kanë marrë kryetarët e

Kuvendit gjatë aktiviteteve ndërkombëtare të tyre. Në mure ka piktura artistike nga artistë të njohur maqedonas.

SALLA E OHRIT

Salla është e ndërtuar në vitin 1954, me rikonstruksionin e parë të pjesës solemne të ndërtesës, ndërsa shfrytëzohet vetëm nga Kryetari i Kuvendit për mbajtjen e



koordinimit të rregullt me nënkryetarët dhe koordinatorët e grupeve të deputetëve, si dhe për punë protokollare, nënshkrim të deklaratave, takime pune dhe aktivitete të tjera.

Me rregullimin e enterierit në vitin 1954 është realizuar drugdhendje murale, tavani me drugdhendje, dyer me drugdhendje dhe karrige me motive popullore nga rajoni i Maqedonisë. Gdhendja është bërë në dru are nga mjeshtër të shkollës për drugdhendje të Ohrit dhe për nder të tyre është quajtur Salla e Ohrit.

SALLA E KOMISIONIT KUSHTETUES

Salla është e ndërtuar dhe rregulluar në vitin 1954 me dërrasa në intarsia



dhe tavane me dekorime gjipsi nga mjeshtër të Drimkolit. Emrin e ka nga Gjykata Kushtetuese, sepse është shfrytëzuar nga gjykata kur ishte e vendosur në ndërtesën

e Kuvendit. Salla shfrytëzohet për mbajtjen e mbledhjeve të trupave të punës, për aktivitete protokollare dhe nënshkrim të dokumenteve.

SALLA E STRUGËS

Salla është e ndërtuar në vitin 1954, gjatë rikonstruksionit të parë të objektit të Kuvendit, me gdhendje të drurit të arës, me motive popullore



nga rajoni i Maqedonisë. Gdhendja e drurit është bërë nga mjeshtër të shkollës për drugdhendje të Strugës dhe për nder të tyre është quajtur Salla e Strugës. Salla shfrytëzohet për aktivitete protokollare

të Kryetarit të Kuvendit, nënkryetarëve, koordinatorëve të grupeve të deputetëve dhe deputetëve.

DHOMA PËRKUJTIMORE E KAÇKM-SË

Dhoma përkujtimore e KAÇKM-së në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë është e ndërtuar në vitin 2004, me rastin e 60-të vjetorit nga mbajtja e Mbledhjes së Parë të KAÇKM-së. Në hapësirë janë të ekspozuara dokumente dhe artefakte nga një prej ngjarjeve më të rëndësishme të të kaluarës së shtetit tonë, mbajtja e Mbledhjes së Parë të KAÇKM-së në manastirin "Shën. Prohor Pçinski".



Përveç kësaj, në hapësirë janë të ekspozuara edhe dokumente të tjera të rëndësishme dhe simbole të ngjarjeve më të rëndësishme nga e kaluara e afërt dhe e largët (periudha e pavarësisë së shtetit, koha e RSFJ-së, Luftës Nacional-Çlirimtare, Kryengritjes së Ilindenit dhe Kresnës dhe të tjera).

SALLA BORIS TRAJKOVSKI

Salla është e ndërtuar në vitin 1954, si ndërtim plotësues në oborrin e Kuvendit, ndërsa shfrytëzohet për mbajtjen e mbledhjeve të trupave të punës, debateve mbikëqyrëse dhe publike, konferencave, seminareve, koordinimeve të grupeve të deputetëve dhe aktivitete të tjera. Në vitin 2009, salla është



e rikonstruksionuar, kështu që në të është vendosur një pjesë e fondit të librave të bibliotekës së Kuvendit. Me rastin e pesëvjetorit të vdekjes së Kryetarit të mëparshëm të shtetit, sala është rimëruar nga Salla 2 në sallën "Boris Trajkovski".

SALLA 3 - SALLA E SHTYPIT

Salla është e ndërtuar në vitin 1967 dhe në fillim është shfrytëzuar për nevojat e mbledhjeve të atëhershme. Në vitin 1999, është kryer rregullimi i enterierit të sallës dhe e njëjta është pajisur me kompjuter, faks, telefona, si



dhe linjë interneti për punë pa pengesa të gazetarëve. Nga viti 2013, sala është rimëruar në Salla e Shtypit dhe është dedikuar për mbajtjen e konferencave për shtyp dhe dhënien e deklaratave nga deputetët para përfaqësuesve të mediave.

SALLA 4



Salla është e ndërtuar në vitin 1967, ndërsa enterieri është rregulluar në vitin 1999. Shfrytëzohet për mbajtjen e mbledhjeve të trupave punues. Në hapësirë ka galeri e cila shfrytëzohet nga gazetarët ose vizitorët e tjerë. Salla është e pajisur me sistem audio, kabinë dhe pajisje për përkthim simultan dhe sistem konferencash.

SALLA E MADHE (SALLA NËN KUPOLLËN E MADHE)



Në nivelin e katërt të ndërtimit plotësues është ndërtuar një sallë për shumë dedikime nën kupollën e madhe. Salla është e pajisur për mbajtjen e konferencave ndërkombëtare me 204 vende për ulje. Kabinat e përkthimit dhe teknika janë ndërtuar në një stil të dy shtëpizave maqedonase.

Salla është hapur në vitin 2016 me rastin e festës së 11 tetorit në kuadër të hapjes solemne të pjesës së re të objektit të Kuvendit.



SALLAT NËN KUPOLLAT E VOGLA

Nën dy kupolat e vogla janë vendosur sallat e vogla të Kuvendit që shfrytëzohen për mbledhjet e trupave punues të Kuvendit. Sallat janë të pajisura me sistem audio dhe video për përkthim simultan dhe me sistem konferencash.



Kryetarët e Kuvendit



**Metodija Andonov-
Čento**
Kryetar i Presidiumit të
KAÇKM-së (1944 - 1946)



Dr. Boris Spirov
(1946 - 1947)



Dr. Dimitar Nestorov
(1947 - 1951)



Dimçe Stojanov - Mire
(1951 - 1953)



Llazar Kolishevski
(1953 - 1962)



Lupčo Arsov
(1962 - 1963)



Vidoe Smilevski - Bato
(1963 - 1967)



Mito Haxhivasilev - Jasmin
(1967 - 1968)



Nikolla Minçev
(1968 - 1974)



Bllagoja Taleski
(1974 - 1982)



Boshko Stankovski
(1982 - 1984)



Kata Llahtova
(1984 - 1985)



Stanko Mlladenovski
(1985 - 1986)



Dr. Vullnet Starova
(1986 - 1991)



Stojan Andonov
(1991 - 1996)
(2000 - 2002)



Tito Petkovski
(1996 - 1998)



Dr. Savo Klimovski
(1998 - 2000)



Nikolla Popovski
(2002 - 2003)



Lupčo Jordanovski
(2003 - 2006)



Lubisha Georgievski
(2006 - 2008)



Trajko Veljanoski
(2008 - 2017)



Talat Xhaferi
(2017 – në vijim)

Dita e hapur në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut organizon Ditë të hapur çdo të premte të fundit të muajit, nga ora 10:00 deri në orën 16:00.



Grupet e organizuara gjatë Ditës së hapur zgjatin rreth një orë. Një grup i vizitorëve mund të përbëhet nga maksimum 40.

Qytetarët e interesuar mund të paraqiten maksimum pesë ditë para mbajtjes së Ditës së hapur, nëpërmjet plotësimit të aplikimit në këtë link poseti.sobranie.mk.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut e mban të drejtën ta ndryshojë terminin ose ta anulojë Ditën e hapur, mirëpo për këtë do t'i informojë në kohë vizitorët e paraqitur.

ПОСЕТА ТИПОВИ НА ПОСЕТИ ПРАВИЛА РАСПОРЕД НА НАСТАНИ

Лични податоци

Термин: 24.10.2019 (ср)	Иницијал
Иницијал на посетител	Датум на посетител
Име	Адреса на посетител
Грло	Страна на посетител
Грло на посетител (не е потребно да се пополнува)	Потпиш
Грло на посетител	Грло на посетител

Од посетителот се бара да се пополнува

ПОДАВАЈЕ

RREGULLAT E SJELLJES

- Pjesëmarrësit janë të detyruar të arrijnë 15 minuta para fillimit të vizitës dhe t'i kalojnë procedurat e sigurisë për hyrje në ndërtesë;
- Çdo pjesëmarrës duhet të ketë kujdes për veshjen që e ka (veshja e papërshtatshme përfshin: pajisje sportive, pantallona të shkurta, mini-funde, bluza me dekolte të thellë ose pa mëngë, pantofla dhe këpucë të ngjashme);
- Celularët duhet të jenë në regjimin pa zë gjatë tërë kohëzgjatjes së vizitës;
- Lejohet fotografimi, por jo edhe video-incizimi në brendinë e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Gjatë vizitës, pjesëmarrësit janë të detyruar të respektojnë rendin dhe qetësinë në ndërtesën e Kuvendit, të mos ngelen pas ose të ndahen nga grupi dhe të respektojnë instruksionet e ciceronit dhe të punësuarve të sigurimit;
- Është e ndaluar futja e ushqimit dhe pijeve në ndërtesë;
- Pirja e duhanit në ndërtesë është e ndaluar në pajtim me dispozitat ligjore;
- Pjesëmarrësit duhet të sillen me kujdes me pronën dhe inventarin në ndërtesën e Kuvendit;
- Nuk lejohet që pjesëmarrësit të largohen me vetiniciativë nga vizita, përveç në raste të ndonjë urgjence;
- Mosrespektimi i ndonjë rregulli do të çojë në largimin e pjesëmarrësit nga ndërtesa e Kuvendit.

SI TË ARRINI NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT?

Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjendet në qendër të Shkupit, në këtë adresë: Bulevardi 11 Oktomvri, numër 10. Deri në ndërtesën e Kuvendit mund të arrihet me autobusët numër: 3, 3a, 4, 4a, 5, 7, 76, 16, 21, 21a, 22, 24, 33 dhe 41.

QASJA DHE HYRJA NË NDËRTESEN E KUVENDIT

Në Ditën e hapur, vizitorët hyjnë nga **Hyrja kryesore** e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke u identifikuar me dokument personal (letërnjoftim ose pasaportë). Është e mundur të qasje e personave me nevoja të veçanta me ndihmë të platformës mobile të montuar. Të punësuarit e sigurimit kanë për detyrë që gjatë hyrjes të kontrollojnë vizitorët dhe sendet personale që i kanë me vete.



PERSONI PËR KONTAKT:

Sonja Stamenkovska, telefoni: 02/3128-227

Ueb-portali për regjistrim: poseti.sobranie.mk

e-mail: s.stamenkovska@sobranie.mk

Publikimi është përgatitur nga Njësia për Edukim dhe Komunikim në Institutin Parlamentar

dhjetor 2019